



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2023

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Sh.A.H.

Adresa: _____ Berat

I nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 1018 prot datë 02.06.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të pikës 1.1 të nenit 20 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet vënia në dispozicion e informacionit për tarikatin R. Berat dhe konkretisht:

1. Fondi i Drejtorisë së Dytë viti 1958- dosja 59 fleta 12 dhe dosja 62 flatët 3,4,5,6,7, ju informojmë se :

Objekti i kërkesës për informacion i nënshtrohet ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, dhe jo ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi informacioni i kërkuar në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nuk konsiderohet informacion publik por informacion për dokumentacion arkivor, e në këtë kuadër procedura për mënyrën se si të aksesohet informacioni, shqyrtohet dhe vendoset në dispozicion, rregullohet nga ligji nr 45/2015.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015, për trajtimin e kërkesës tuaj, për vënie në dispozicion të dosjes apo dokumentacionit për tarikatin R.Berat, nevojitet të plotësoni formularin përkatës për individët apo studiues të miratuara nga Autoriteti me qëllim adresimin menjëherë të kërkesës tuaj, në strukturën përkatëse të institucionit.

Bashkëlidhur gjeni formularin për individët, formularin për studiues të miratuara nga Autoriteti.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave

Sofi Noti